



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA
DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI



R A P O R T I I V J E T O R I P U N Ë S

01.01.2022-31.12.2022

VITI, 10.01.2023

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi dhe Arsyeshmëria.....	3
2. Korniza Ligjore.....	4-5
3. Sektorët.....	6
3.1 Sektori i Kadastrit.....	6-7
3.2 Sektori i Pronës.....	8-9
3.3 Sektori i Gjeodezisë.....	10
4. Të hyrat financiare për 2022.....	11
5. Sfidat	11

1. Qëllimi dhe arsyeshmëria e Raportit

Me qëllim të rritjes së transparencës ndaj qytetarëve dhe obligimeve ligjore, të bazuar me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarin dhe udhëheqjen e Pushtetit lokal, akteve tjera të cilat në mënyrë të veçantë rregullojnë punët dhe shërbimet, që i ofron Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi janë si bazament kryesor i paraqitjes së këtij raporti vjetor për periudhën janar-dhjetor 2022.

Puna dhe objektivat e DKPGJ-së kanë qenë të bazuar në planin e punës për vitin 2022, po ashtu kërkesave të palëve sit e personave fizik ashtu edhe të atyre juridik.

Shërbimet e ofruar nga DKPGJ-ja në vitin 2022 kanë qenë 100% në shërbim të qytetarëve, duke i tejkaluar planifikime. Kjo e bënë që të rritet përforcua dhe transparenca në raporte me qytetarin.

Duke u rritur rëndësia e shërbimit me efikas dhe brenda kornizave ligjore po rritet edhe transparenca e DKPGJ-së ndaj qytetarit.

Synimi ynë në 2022. ka qenë shërbimi dhe shqyrtimi i të gjitha lendeve brenda afateve ligjore dhe në mënyrën më të mirë të mundshme, të cilin synim e kemi arritur. Këtë mund ta vëreni edhe në kapitujt e mëposhtëm të këtij raporti.

Në raport kemi paraqitur kornizat ligjore, me të cilat punohen, pastaj për secilin sektor veç e veç llojet e shërbimeve kryesore që janë kryer, dhe numrin e madh të shërbimeve të ofruar dhe transaksioneve pronësore të regjistruara.

Qëllimi kryesor është që përmes këtij raporti, metodave të aplikuara dhe grafikoneve të paraqitura shkurtimisht, qytetaret të jenë të njoftuar me punën e arriturat, shërbimet dhe sfidat e DKPGJ-së gjatë viti 2022.

2. Korniza Ligjore

Gjatë kryerjes së punëve dhe shërbimeve administrative ne Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi janë aplikuar të gjitha ligjet që rregullojnë çështjet pronësore dhe te fushës së gjeodezisë, e gjithë puna për këtë periudhë ka qenë e bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi. Përkushtimi ka qenë maksimal, qe te gjitha transaksionet pronësore dhe shërbimet tjera qe ofron DKPGJ-ja te kenë bazament këto Ligje, Udhëzime Administrative, Korniza Pune dhe Udhëzues Pune, po ashtu si akte tjera juridike bazë për ta bërë një transaksion gjithmonë jemi bazuar në aktgjykimet e plotëfuqishme të Gjykatave, aktvendimet dhe kontratat e Zyrave Noteriale dhe akteve administrative tjera të sjella nga organet Komunale.

2.1 Ligjet

- Ligji për Kadastër Nr. 04/-L-013, i datës 29.07.2011.
- Ligji për hipotekat Nr.2002/04.
- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve Nr.02/L-96 të datës 10.05.2012.
- Ligji për ndërtesat e banimit në bashkë pronësi Nr.04/L-134 të datës 29.07.2013.
- Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore Nr.03/L-154 të datës 25.06.2009.
- Ligji për Planifikim Hapësinor Ligji Nr. 04/L-174, të datës 21.09.2013.
- Ligji për Sistemin e Adresave Ligji Nr.04/L-071, të datës 8.12.2011.

2.2. Udhëzimet administrative UDHËZIMET ADMINISTRATIVE

- Udhëzimi administrativ Nr.24/20013, për Procedurat e Krijimit dhe Administrimit të Adresave dhe Regjistrit të Adresave.
- Udhëzimi administrativ Nr.AKK 2006/01, Mbi Zbatimin e Ligjit mbi Themelimin e Regjistrit mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme.
- Udhëzimi Administrativ Nr.02/2013 për Zbatimin e Ligjit për Kadastër.
- Udhëzimi Administrativ Nr.14/2012 për Krijimin dhe Administrimin e Listës Alfabetike për Emërtime, Listës Rezervë dhe Vendosijen e tyre nga Regjistri Komunal i Adresave.
- Udhëzimi Administrativ Nr.06/2012 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe të Gjeodetëve.
- Udhëzimi Administrativ Nr.05/2012 për Tarifat e Shërbimeve dhe të Produkteve Kadastrale të ofruara nga Zyrat Kadastrale të Kosovës dhe Kompanitë Gjeodete të Licencuara.

-
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për fushatën e Sensibilizimit të Publikut gjatë Rindërtimit të Kadastrit dhe Regjistrit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme.
 - Udhëzimi Administrativ Nr.02/2012 për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme.
 - Udhëzimi Administrativ Nr.03/2012 për Punën e Komisionin për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme

2.3 Korniza Pune

- Kornizë pune NR.AKK 2013/02 për Standardizimin e Matjeve dhe Rilevimeve Kadastrale.
- Korniza NR.AKK 2013/01 për Korrigjimin e Sipërfaqeve.
- Modelimi i dorëzimit të Dhënave në Regjistrin në Kadastër.

2.5 Udhëzues pune

- Rrjeti referent i rendit të II-të.
- Përdorimi i softverit geospro për mutacion.
- Transformimi i të dhënave kadastrale nga sistemi fryref30 në kosovaref01.
- EDM kalibrimi i instrumenteve në bazën kontrolluese zyrtare.
- Poligonet dhe matjet e detajit.
- Instrumenti – Stacioni Total.
- Rrjeti referent i rendit të III-të dhe lokal.
- Matjet kadastrale në Kosovë, Libri I.
- Matjet kadastrale në Kosovë, Libri II.
- Sipërfaqet.
- Direktivat për mirëmbajtjen e informacioneve kadastrale.
- Rregullorja Nr.01-110/05-221 të datës 01.03.2022. për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha
- Raporti Final nga Zyra e Njësisë e Auditorit të Brendshëm

3. Sektorët e DKPGJ-së

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, është e rregulluar me një sistemim dhe në bazë të organogramit të brendshëm dhe përshkrimit të detyrave dhe obligimeve të punës të secilit zyrtar, ku aktualisht në këtë drejtori punojnë 9. zyrtar të cilët janë me kualifikimet e nevojshme për të plotësuar nevojat e punës dhe të funksionimit të secilit sektor në Drejtori.

Në kuadër të DKPGJ-se ekzistojnë tre sektor:

- Sektori i Kadastrit
- Sektori i Pronës, dhe
- Sektori i Gjeodezisë

3.1 Sektori i Kadastrit

Puna në Sektorin e Kadastrit është e bazuar në dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë këtë sektor, i cili është përgjegjës për kujdesen dhe mirëmbajtje e të gjitha regjistrave kadaslral, ku përfshihet e gjithë paluajtshmeria komunale, si dhe regjistri i paluajtshmerive, hipotekave, servituteve digjitale dhe manual, si shërbim kryesor për qytetarët si shërbimi me lëshimin e fletave poseduese, çertifikatave personale dhe socialë.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime :

Tabela nr.1 Shërbimet kadastrale 2022

	Lënda	Nr. lëndve
1	Kontrata shitje	577
2	Kontrata falje	388
3	Trashigimi	164
4	Aktgjykime	41
5	Hipoteka	59
6	Lirim hipoteke	37
7	Kontrata këmbimi	12
8	Kontratë mbajtjes	3
9	Qiramarrje	4
10	Ndarje fizike	2
11	Korigjime	15
12	Vendime përmbarimi	3
13	Lëndë zyrtare	15
14	Bashkëpronësi	75
15	Të ndyshme	29
16	Përgjigjëje në kërkesa	24
	Gjithësejt:	1448

Shërbeme tjera kadastrale:

FLETA POSEDUESE	KOPJE PLANI ME PAGES	NUK POSEDON PASURI	RASTE SOCIALI	FLETAPOSEDUSE ZYRTARISHT	KOPJE PLANI ZYRTARISHT	VETERAN	GJITHSEJT
3424	1096	93	1096	153	65	63	5990

3.2 Sektori i Pronës

1. Propozim – vendim për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik në zonën kadastrale në Viti- parkingjet publike.
2. Propozim – vendim për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale afat shkurtër përmes ankandit publik në zonën kadastrale në Devajë.
3. Propozim – vendim për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale afat shkurtër përmes ankandit publik në zonën kadastrale në Smirë.
4. Propozim – vendim për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale afat shkurtër përmes ankandit publik barnatorja në objektin e QKMF-së në zonën kadastrale në Viti.

5. Propozim vendimet për formimin e komisioneve:

6. 1. Propozim – vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për ankandin publik të dhënjes në shfrytëzim të pronës komunale parkingjet publike.
7. 2 Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënjën e pronës palujtshme të komunës në shfrytëzim në zonën kadastrale në Devajë
8. 3. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënjën e pronës palujtshme të komunës në shfrytëzim në zonën kadastrale në Smirë.
9. 4. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënjën e pronës palujtshme të komunës në shfrytëzim – barnatorës në zonën kadastrale në Viti.
10. 6. Për plotësimin – ndryshimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e
11. procedurave për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale me nr.01-110/05-100, të datës 01.03.2021 (parkingjet publike).

12. Propozim- vendimet për shpalljen me interes përgjithshëm :

13. 1 Propozim – vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01-110/05-1067, të datës 28.09.2022 për shpalljen interes te përgjithshem ngastrën kadastrale në zonën kadastrale në Viti, Radivojc dhe Sllatinë
14. 2. Propozim – vendim për shpalljen interes te përgjithshem ngastrën kadastrale me nr.00002-3, në zonën kadastrale në Letnicë
15. 3. Propozim – vendim për shpalljen interes te përgjithshem për hapjen e rrugës së re në zonën kadastrale në Sllatinë
16. 4. Propozim – vendim për shpalljen interes te përgjithshem ngastrën kadastrale me nr.3765-1, në zonën kadastrale në Viti

Propozim vendimet për caktim lokacioni janë :

1. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndertimin e objekt të ambullantës në fshatin Gushicë.
2. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e bustit të martiri Milaim Tahiri në fshatin Gërmovë
3. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndertimin e Çerdhës së femijëve në Viti.
4. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndertimin e objekt të Gjykatës Themelore në Gjilan dega në Viti.

5 Propozim – vendim për caktimin e lokacionit për ngritjen e obeliskut Madelein Albright në qytetin e Vitisë.

6. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndertimin e objektit për personat me aftësi të kufizuar në fshatin Pozheran.

7. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash. Propozim- vendim për shfuqizimin e vendimit paraprak me nr.01-110/05-477, të datës 04.05.2022, për shpalljen me interesë të përgjithshëm për hapjen e rrugës së re në zonën kadastrale në Sllatinë.

8. Propozim – vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01-110/05-110, të datës 01.02.2022 për caktimin e lokacionit për ndertimin e objekt të Gjykatës Themelore në Gjilan dega në Viti

9. Propozim vendim për miratimin e listës së veqant të pronave të palujtshme të komunës që planifikohen për dhënjën në shfrytëzim gjatë vitit 2023.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime :

Nr.	Propozim - vendimet	sasia
1	Propozim vendime për dhënjën në shfrytëzim pronës komunale	4
2.	Propozim vendime për formimin e komisioneve për dhënjën në shfrytëzim pronës komunale	6
3.	Propozim vendime për shpalljen me interes të përgjithshëm	4
4.	Propozim vendime për caktim lokacionit	7
5.	Propozim vendime për plotësim të vendimit	1
6.	Propozim vendime për shfuqizim të vendimit	1
7.	Propozim vendime për listen e veqant për dhënjën në shfrytëzim pronës komunale	1
	Gjithsejt:	24 propozim vendime

3.3 Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë për gjatë vitit ka kryer këto shërbime për palët dhe Komunën si ka : Mirëmbajt kadastrën digjital në sistemin kosovaref01 ka përcjell vektorizimin e raster planeve, ka përgatitë dhe mbikëqyrë të dhënat për kompanitë dhe gjeodetët e licencuar, ka përgatitë raportet ditore për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka pranuar lëndët e kryera nga kompanitë dhe gjeodetët e licencuar dhe të njëjtat i azhurnon në sistemin zyrtar (Geomedia profesional 5.2), ka bërë azhurnimin e ndarjeve fizike në librat e regjistrimeve të ndarjeve kadastrale, ka bërë Hartimin e kopjeve të Planit, Kontroll të vazhdueshme kualitetit të të dhënave grafike kadastrale dhe atyre tekstuale, projektim të rrjeteve referente, të rendit të tretë të shtruar me GPS, Mirëmbajtje për rrjetat referente të rendit të tretë për tërë zonat kadastrale në kuadër të komunës së Vitisë, Identifikim i parcelave në zyrë. Futja e të dhënave grafike në datamodelin zyrtar (Geomedia Professional & Geospro). Konsulta dhe këshilla profesionale në lëmin e Gjeodezisë dhe Kadastrës, për palët e interesuara në kuadër të shërbimeve kadastrale. Ekspertiza kadastrale për nevoja të Gjykatave.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime:

Bashkim parcelave	82 lëndë
Ri-rregullim kufiri	4 lëndë
Ndarje parcelave	281 lëndë
Historiate parcelave	1 lëndë
Ndërrim kulture	5 lëndë
Regjistrim banesave	6 lëndë
Gjithësejt:	379 lëndë

4. Të hyrat financiare për 2022

Gjatë vitit 2022. Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi kemi arrit të tejkalojmë planifikimin e të hyrave financiare dhe të arrimë të përmbushim një nga objektivat kryesore të punës së kësaj Drejtorie.

Të hyrat e planifikuara për vitin 2022. Kanë qenë : **57,400.00**

Të hyrat e realizuara në vitin 2022 janë **93,732.00**

Të shprehura në përqindje realizimi ka qenë: 163.3%

Në këtë drejtori gjatë kësaj periudhe janë përfunduar:

7841. kërkesa.

5. Sfidat

5.1 Pengesat të cilat i përcjell këta Sektor janë:

- Mungesa e shënimeve prej vitit 1985 – 1999.
- Lidhjet e dobëta digjitale në bazën e të dhënave dhe shpeshherë ndërprerja e tyre kohë pas kohe me Agjensionin Kadastral të Republikës së Kosovës.
- Mungesa e shënimeve gjeodezike nga viti 1985 – 1999.
- Mungesa e planeve/skicave për zonat kadastrale. të cilat janë pjesë të komasacionit.

5.2 Propozim masat të cilat duhet të merren për efikasitet janë:

- Insistimi i faktorëve institucional, vendor dhe ndërkombëtar tek Institucionet e Serbisë për kthimin e shënimeve kadastrale dhe gjeodezike, respektivisht planeve gjeodezike.
- Insistimi i institucioneve vendore dhe i mekanizmave ndërkombëtar tek institucionet e Serbisë, për kthimin e dokumentacionit kadastral, të konfiskuar (grabitur gjatë luftës).
- Përpjekjet për përmirësimin e lidhjeve digjitale në bazën e të dhënave me Agjensionin Kadastral të Republikës së Kosovës.

Ajet Sallahu

UD.Drejtori të DKPGJ

